



Planuar / Dorezuar Prijeheno/Protato Received/Delivary	20.07.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojt e Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUPSHINA	4215/2022		112



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.558/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional-në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.558/2022 të datës 22.06.2022, të parashtruar nga ankuesja në çështjen juridike "kompensim material", për moszbatim të Vendimit me Nr.10/69 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe të Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 20.07.2022, mori këtë:

### V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.558/2022 të datës 22.06.2022, e parashtruar nga ankuesja

### A r s y e t i m

Ankuesja me datë 20.06.2022 ka parashtruar ankesë nëpërmjet Postës së Kosovës për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të cilën ankesë Këshilli e ka pranuar me datë 22.06.2022 me numër të protokollit 3639/2022, me pretendim ankimore për mos përfitimit të njëqindë (100) Euro në bazë të vendimit të Qeverisë Nr.10/69 të datës 13.04.2022 lidhur me mbështetjen e qytetarëve të Republikës së Kosovës në kuadër të Pakos së Ringjalljes Ekonomike për familjet me asistencë sociale, punëtorët e sektorit publik dhe atij privat dhe studentët.

*Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:* Ankesën e ankueses së datës 22.06.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kontrata e punës e datës 21.06.2018; Raporti mjekësor i Spitalit Përgjithshëm në Pejë i datës 09.02.2022; Raporti mjekësor i datës 11.02.2022; Raporti mjekësor i datës 15.03.2022 si dhe Vendimi i datës 01.04.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të





Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuseses [redacted] sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i'u referuar provave të lëndës, konstaton se ankuesja sipas kontratës së punës së datës 21.06.2018 është e punësuar në vendin e punës "Kuzhinierë", në Qendrën e Paraburgimit në Pejë-Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe se me datë 22.06.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendim ankimor për mos përfitim të njëqindë (100) Euro në bazë të vendimit të Qeverisë Nr.10/69 të datës 13.04.2022 lidhur me mbështetjen e qytetarëve të Republikës së Kosovës në kuadër të Pakos së Ringjalljes Ekonomike për familjet me asistencë sociale, punëtorët e sektorit publik dhe atij privat dhe studentët

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke iu referuar provave të lëndës, ka konstatuar se: sipas Ligjit, Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenit 2 paragrafit 6 përcaktohet se: **4. Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike**, andaj ne rastin konkret pozita „Kuzhinierë”, në Qendrën e Paraburgimit në Pejë-Shërbimi Korrektues i Kosovës është kategorizuar si nëpunës administrativo-teknik dhe mbështetës, Kolegji vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për nëpunësit **administrativo-teknik - dhe mbështetës**.

Ndërlidhur me këtë pjesa VII e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka trajtuar në mënyrë të detajuar marrëdhënien e punës së nëpunëseve **administrativo-teknik - dhe mbështetës**, mbi këtë bazë dhe duke ju referuar dispozitave të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën me numër A.nr.558/2022 të datës 22.06.2022, të parashtruar nga ankuesja [redacted] sepse Këshilli shqyrton dhe merr vendim për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A.Nr. 558/2022

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

### Vendimi i dërgohet:

- Ankuseses
- Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Arkivit të KPMShCK-së.